



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:069152

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05939597

C.nr. 112/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarës Fllanza Hashani, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit: P. K, nga Klina, Rr. "Sheshi Nënë Tereze", nr. 43, të cilin e përfaqëson i autorizuari Hil Prenaj, avokat në Klinë, kundër të paditurës: Firma L. G shpk, me pronar H. Th dhe M Th, të cilët i përfaqëson me autorizim V. P. nga Klina, me bazë juridike: Vërtetim pronësie në bazë të pohimit, vlera e kontestit: 4,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 08.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e datës 06.04.2022, e paditësit P. K, nga Klina, kundër të paditurës: F. L.G SH.P.K, me pronar H Th dhe M. Th, me bazë juridike: Vërtetim pronësie në bazë të pohimit, vlera e kontestit: 4,000.00 euro.

II. Secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me datë 06.04.2022, kundër të paditurës: F L. G. SH.P.K, me pronar H Th dhe M Th, me bazë juridike: Vërtetim pronësie në bazë të pohimit, vlera e kontestit: 4,000.00 euro.

I autorizuari i paditësit pas seancës në vendshiqim të mbajtur me datë 18.03.2024, me parashtrësën e datës 27.05.2024, e ka njoftuar gjykatën që e tërheq padinë dhe kërkesëpadinë në raport me të paditurën.

Gjykata me datë 28.05.2024, e ka njoftuar të paditurën lidhur me tërheqjen e padisë, mirëpo e paditura nuk është deklaruar lidhur me këtë njoftim brenda afatit 7 ditësh, dhe për këtë gjë konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. . Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.112/22, datë 08.07.2024

Gj y q t a r j a:
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.